



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

	Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	
	KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS SUDSKI SAVET KOSOVA KOSOVO JUDICIAL COUNCIL	
Nr.Br.No.	01 / 55	
	27. 01. 2020	
	PRISHTINË - A	

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, duke u mbështetur në nenin 7, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, 1.3, 1.4, nenin 30 dhe 31 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenin 14 paragrafi 1 dhe nenin 15 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L – 054 për Gjykatat, nenit 9, 12, 14 dhe nenit 17 të Ligjit Nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, në mbledhjen e mbajtur më datën 27 janar 2020, miraton këtë:

RREGULLORE (Nr. 01/2020)

PËR PLOTËSIMI DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES (Nr. 09/2016) PËR PROCEDURAT E ZGJEDHJES, EMËRIMIT, VLERËSIMIT, PEZULLIMIT DHE SHKARKIMIT TË KRYETARËVE TË GJYKATAVE DHE GJYQTARËVE MBIKËQYRËS

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj Rregulloreje është të plotësoj dhe ndryshoj Rregulloren (09/2016) mbi Procedurat e Zgjedhjes, Emërimit, Vlerësimit, Pezullimit dhe Shkarkimit të Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës të ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren 14/2016, Rregulloren 17/2016 dhe Rregulloren 05/2017.

Neni 2

Neni 2 paragrafi 1 i Rregullores riformulohet si në vijim:

1. Zgjedhja dhe emërimi i kryetarëve të gjykatave dhe gjyqtarëve mbikëqyrës bëhet përmes një procesi të hapur, konkurrues, transparent dhe meritor, siç përcaktohet me ligj, duke përjashtuar çfarëdo lloj diskriminimi.

Neni 3

Neni 4 i Rregullores, ndryshohet dhe plotësohet si në vijim:

1. paragrafi 2, pika 2.3 riformulohet: *të mos ketë sanksion disiplinor me vendim të formës së prerë, përjashtimisht nëse ndaj tij është shqiptuar masa e qortimit ose vërejtjes jo-publike, në pesë vitet e fundit.*

2. paragrafi 5 riformulohet: *Këshilli Gjyqësor i Kosovës do të merr në konsideratë trajnimet e specializuara, përvojën menaxheriale dhe vlerësimin e performancës të kandidatit për kryetar të gjykatës dhe jytare mbikeqyres.*

3. paragrafi 6, pika 6.2 riformulohet: *kryetari i gjykatës apo gjyqtari mbikqyrës i cili ka përfunduar mandatin e tij si kryetar gjykate apo gjyqtar mbikqyrës.*

Neni 4

Neni 5 i Rregullores, paragrafi 1, pika 1.2. riformulohet: *raportin e vlerësimit nga Komisioni i Vlerësimit të Performancës të kryer në tre vitet e fundit.*

Neni 5

Neni 6 i Rregullores, paragrafi 2, fshihet dhe riformulohet si në vijim: *Këshilli Gjyqësor i Kosovës do të bëjë vlerësimin e përshtatshmërisë së kandidatit për kryetar dhe gjyqtar mbikeqyres nëpërmjet vërtetimit të të dhënave të dorëzuara nga kandidati, të dhënat nga regjistrat publik relevant për vlerësim, përfshirë verifikimin standard të regjistrave për të kaluarën kriminale.*

Neni 6

Neni 16 i Rregullores, fshihet paragrafi 3 dhe 4 dhe zëvendësohen me paragrafin 3 me tekstin si në vijim:

"3. Në rastet kur arsyeja për shkarkim paraqet shkelje disiplinore, zbatohen dispozitat e Ligjit për Përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve".

Neni 7

Neni 17, 18, 19, 20, 21, 22 dhe 23 i Rregullores fshihen dhe si të tilla shfuqizohen.

Neni 8

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Këshilli.

Prishtinë, më datë 27.01.2020

Skender COCAJ,
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

